

RAPORT MONITORIMI

ANALIZA E SHPENZIMEVE FINANCIARE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI

VITI AKADEMIK
2020 - 2021

AL/EN



QENDRESA
QYTETARE

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Realizuan:

Autor: Rigels Xhemollari

Ekspertë monitorimi:

Besjana Hysa

Ines Mulellari

Ekipi i monitoruesve:

Paola Ymet

Dragana Kurti

Fatjon Biba

Tea Zeqaj

ISBN:

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

2021

TABELA E PËRMBAJTJES

1. ÇFARË PËRMBAN RAPORTI I MONITORIMIT?
2. SI ADMINISTROHEN FINANCAT NË IAL-TË PUBLIKE?
3. METODOLOGJIA E MONITORIMIT
4. GJETJET KRYESORE
5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 6 UNIVERSITETE PUBLIKE
 - a. Kategoria “Shpenzime Personeli”
 - b. Kategoria “Investime”
 - c. Kategoria “Blerje mallrash”
 - d. Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”
 - e. Kategoria “Bursa dhe transfertat për subvencione të tjera”
 - f. Kush janë kontraktorët preferencialë të universiteteve publike?
 - g. Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike për vitin akademik 2020-2021
6. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL
7. REKOMANDIME
8. SKEDAT E TRANSPARENCËS

1. ÇFARË PËRMBAN RAPORTI I MONITORIMIT?

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes përmes angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, tarifat e larta që aplikohen në to, dhe në tërësi nga ankesat e artikuluara gjatë protestës së studentëve në muajin Dhjetor 2018, vendosëm të kryejmë këtë monitorim me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, i cili realizohet për të tretin vit akademik rradhazi.

Vlera e këtij monitorimi, i cili u realizua edhe vitin e shkuar, konsistoi në përdorimin e të dhënave nga të gjithë aktorët universitarë, qeveria dhe studentët për të ndërmarrë masat dhe politikat për përmirësimin e situatës së transparencës dhe mirëmenaxhimit të parave.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, **Qëndresa Qytetare monitoroi gjashtë universitete publike** me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për **periudhën 1 shtator 2020 – 31 gusht 2021**.



Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar kështu t'i japë përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve? A përkthehen në shërbime dhe shkencë apo kemi të bëjmë me një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve?

Gjithashtu kjo nismë adreson një problematikë për të cilën qeveria, si rezultat i presionit të lartë të studentëve ku një prej shkaqeve ishte keq menaxhimi i parave, në "Paktin për Universitetin" ndërmori masa duke zëvendësuar Anëtarët e Bordeve të Administrimit me figura publike si reflektim për më shumë efikasitet nga Anëtarët e Bordeve përfaqësues të MASR dhe më pas për të përzgjedhur përfaqësues të studentëve tek një prej anëtarëve të bordit. Duhet përmendur që disa prej zgjedhjeve të cilat lanë për të dëshiruar dhe nuk dhanë efektin e pritur.

Qendresa Qytetare ndërmjet këtij monitorimi synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence, nisur dhe nga fakti që tashmë është krijuar edhe portali u-transparenca.al, një database që synonte të përmbante çdo informacion në lidhje me shpenzimet e universiteteve.

1. SI ADMINISTRROHEN FINANCAT NË IAL-TË PUBLIKE?

Bazuar në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, menaxhimi financiar i universiteteve publike është i ndarë nga menaxhimi akademik. Autoritetet kryesore përgjegjëse për menaxhimin financiar janë: Bordi i Administrimit, Administrator i Universitetit dhe Administratorët e Fakulteteve.

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.

3 (tre) Anëtarë, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga Senati Akademik i institucionit përkatës, 4 Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron anëtarët e bordit për secilin institucion të arsimit të lartë.

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

3. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Ekipi i monitoruesve të Qëndresës shfrytëzoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit. Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përfthuara nga **transaksionet e Thesarit**.

Gjetjet e analizuara të transaksioneve të Thesarit u pasuruan me të dhënat e përftuara nga shfletimi i **buletinit të prokurimeve publike**, ku duken qartazi kontratat dhe objektet e marrëveshjeve që titullarët e universiteteve publike lidhin me operatorë të tretë për shërbime dhe produkte në plotësim të nevojave të universitetit.

Njëkohësisht, plot **8 kërkesa për informacion** drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve, ku u administruan një sasi e madhe dokumantash financiare që përmbanin kontrata, fatura, oferta dhe çmime të blerjeve të realizuara nga 6 universitetet e përzgjedhura.

Në shqyrtim janë marrë të dhënat e 6 universiteteve publike, konkretisht:

Universiteti i Tiranës (U.T)
 Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan (U.E),
 Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (U.K),
 Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD),
 Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër (U.SH),
 Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)



4. GJETJET KRYESORE

- UPT zë vendin e parë për shpenzime të administratës, ku në 1 vit kalendarik përveç pagave bazë ka shpenzuar **357 750 Euro për shpërblime, 101 900 Euro për dieta, 50 500 Euro për karburant makine, 28 000 Euro për telefon/internet dhe 290 000 Euro pagesa të Bordit dhe Senatit Akademik.**
- Megjithëse godinat kanë qëndruar bosh gjatë 1 viti të plotë akademik, 6 universitetet kanë shpenzuar për ngrohjen e tyre shuma të konsiderueshme 332 000 Euro . Universiteti i Shkodrës ka blerë **51 500 Euro gazoil për ngrohjen e godinave.**
- Vetëm dy nga 6 universitete kanë shpenzuar për shkencën. **Nga 4.6 milion Euro të përdorura për zërin “Investime” në një vit kalendarik, vetëm 0.4% kanë shkuar për kërkim shkencor.**
- Universitetet publike kanë kryer shpenzime të larta për blerje kancelarish dhe orendish zyrash, por nuk kanë bërë transparente detajet e mallrave të blerë. UPT ka shpenzuar **410 000 Euro për orendi zyrash** pa publikuar detajet e tyre ndërsa Universiteti i Tiranës e ka përdorur pothuajse të gjithë buxhetin e këtij zëri **73 100 euro për të blerë letra A4.**
- Pavarësisht se ky viti akademik është zhvilluar në distancë, 4 nga 6 universitetet e monitoruara kanë përshkruar distanca të konsiderueshme duke shpenzuar karburant për makinat. UPT ka shpenzuar **50 500 Euro karburant me tollona** vetëm për tre muaj gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2020.
- Godinat bosh janë ruajtur me shifra marramëndse gjatë një viti kalendarik. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar **555 250 Euro për roje dhe 236 200 Euro për kamera sigurie.** UPT ka paguar **20 600 Euro për sigurimin e pasurisë së universitetit,** ndërsa Universiteti i Elbasanit, i cili administron një numër më të ulët godinash ka shpenzuar gati **dyfish më shumë** se universitetet e tjera të rretheve për roje.
- Portali **u-transparenca.al** nuk përmban të dhëna mbi prokurimet dhe kontratat e IAL-ve me të tretët për vitin 2020 - 2021. **Kjo mungesë u vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të universitetit, detajet nën zëra** dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 6 UNIVERSITETE PUBLIKE

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer gjashtë universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjatë periudhës **1 shtator 2020 – 31 gusht 2021, përkatësisht një vit të plotë kalendarik, përfshirë edhe atë akademik.**

Nëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personeli duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuar.

Siç kuptohet nga tabela, shpenzimet e Universiteteve sipas zërave të kategorive shkojnë pak a shumë në proporcion të rregullt me shpenzimet totale të secilit prej tyre. Në pesë nga gjashtë universitet e marrë në monitorim, pjesën thelbësore të shpenzimeve e zënë shpenzimet për personelin të kategorizuara në kategorinë 2. Ndrysim bën vetëm Universiteti i Tiranës i cili shpenzimet më të mëdha i ka në kategorinë 3. “Investime” pasuar nga kategoria V “Sigurimi Shërbimeve”, kjo ndikuar dhe nga rikonstruksioni i godinës së Fakultetit Ekonomik.

Gjatë periudhës 1 shtator 2020 – 31 gusht 2021 këto 6 Universitete kanë shpenzuar në total:

Kategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U.Korçës	U.Durrësit	UPT
II Shpenzime personeli	311,446,500	74,864,303	367,456,470	263,947,957	486,192,147	666,940,710
III Investime	12,408,582	189,801,466	31,011,162	18,034,490	125,303,500	178,815,832
IV Blerje mallrash	9,481,542	55,339,972	31,070,503	20,282,678	75,190,026	108,728,921
V Sigurimi i shërbimeve	32,370,924	163,876,151	93,734,199	24,777,896	36,628,423	59,308,535
VI Transferta dhe Subvencione	1,494,816	14,758,441	5,616,903	3,276,938	8,058,816	46,718,597
VII Të tjera	54,980,000	2,562,105	124,974,314	45,290,388	75,942,388	109,930,140
Totali	422,182,364	501,202,438	653,863,551	375,610,347	807,315,300	1,170,442,735

a. Kategoria “Shpenzime Personeli”

Kategoria e “Shpenzimeve të personelit” është ndër kategoritë që zënë peshën kryesore të shpenzimeve të universiteteve. Universiteti Politeknik i Tiranës është universiteti që ka bërë dhe shpenzimet më të larta në kategorinë “**Paga**” në total me vlerën 666,940,710 Lekë, ku peshën kryesore e zë zëri 2.1 “Paga (bazë)” me totalin prej 532,361,054 Lekë. UPT pasohet nga UAMD, me vlerën 486,192,147 Lekë shpërndarë thuajse në mënyrë të barabartë në dy zërat “Paga (bazë)” me vlerën

218,492,633 Lekë dhe "Honorare (shpërblime për personelin)" me vlerën 211,480,865 Lekë.

Brenda kategorisë së pagave shpesh, nga të gjashtë universitetet shohim konfuzion në përdorimin e zërave të thesari. Vihen re paga bazë që kalojnë si honorarë, kontrata me kohë të kufizuar që kalojnë për pagë bazë etj. Këto konfuzione dhe mungesë transparence në zëra shfaqen kryesisht brenda kategorisë kryesore. Gjithashtu në një vëzhgim më të detajuar të zërave shohim që Universiteti i Shkodrës tek honorarët ka kryer në mënyrë të përsëritur disa transaksione honorarësh në kuadër të dy projekteve "Safe Harbor" dhe "Fost INN". Po ashtu dhe UPT tek zëri "Honorarë" ka pagesë "grup pune projekti" me AKSHI-n dhe gjithashtu në zërin "Honorarë" ka disa transaksione pagesë shpërblim ndaj të tretëve pa specifikuar arsyen.

Kategori /Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
Shpenzime personeli total	311,446,500	74,864,303	367,456,470	263,947,957	486,192,147	666,940,710
Paga	291,755,792	50,113,708	263,042,037	241,402,391	218,492,633	532,361,054
Honorare + Të tjera shpërblime për personelin	5,158,097	23,319,021	100,136,899	7,775,505	211,480,865	43,288,269
Paga me kontratë për kohë të kufizuar	13,474,088	1,028,000	0	10,164,749	45,521,418	43,875,787
Dieta Udhëtime	804,370	403,574	575,733	2,499,362	1,181,161	12,340,042
Pagesa anëtarët e Bordit Administrativ(+ Senati)	254,153	0	3,701,801	2,105,950	9,516,070	35,075,558

b. Kategoria "Investime"

Në kategorinë "Investime" Universiteti i Tiranës ka shpenzimet më të larta me vlerën 180,801,466 Lekë, ku peshën kryesore e zë Rikonstruksioni i ndërtesave shkollore me vlerë 160,248,261 Lekë.

Universiteti i dytë me më shumë shpenzime për këtë zë është UPT, me një total prej 178,815,832 Lekësh nga të cilat 104,673,929 Lekë në zërin "Rikonstruksion ndërtesash". Ndërkohë asnjë nga universitetet nuk ka shpenzuar në zërat "Pajisje pastrimi" dhe "Mjete transporti". Zërin e "Kërkimit shkencor" e kanë përdorur vetëm Universiteti i Elbasanit me vetëm 86 100 Lekë dhe UPT me 2 054 249 Lekë. 4 (katër) universitetet e tjera të marra në monitorim nuk kanë shpenzuar para për kërkimin shkencor.

Nga trasaksionet e kryera në nënkategorinë "Investime" bien në sy disa blerje të dyshimta në funksion të procesit mësimor si blerja e një portreti në vlerën 53 400 Lekë nga Universiteti Politeknik i Tiranës apo një piano nga Universiteti i Shkodrës në vlerën 690 000 Lekë.

Universiteti i Tiranës ka kryer një transaksion me vlerën 132,000 Lekësh ndaj kompanisë “Oni Trade”, me përshkrimin pajisje (orendi zyre). Nga kërkimi në regjistrin e QKB rezultoi që Oni Trade është një kompani që merret me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të promocionit dhe jo pajisjeve të zyrave.

Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
III Investime	12,408,582	189,801,466	31,011,162	18,034,490	125,303,500	178,815,832
3.1 Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	11,706,582	160,248,261	0	15,230,610	93,350,585	104,673,929
3.2 Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0
3.3 Mjete transporti (dhe Shërbime të tyre)	0	0	0	0	0	0
3.4 Mjete dhe pajisje teknike	702,000	0	15,399,120	1,941,680	9,330,035	22,470,066
3.5 Pajisje zyre dhe orendi të tjera	0	29,553,205	15,525,942	862,200	22,622,880	49,617,588
3.6 Studime dhe kërkime	0	0	86,100	0	0	2,054,249

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	
1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor	Emri: Universiteti Politeknik i Tiranës Adresa: Sheshi "Nene Tereza", nr. 4, Tiranë Personi përgjegjës: Adnan MEMA E-mail: adnan.mema@yahoo.com Në telefon: 355 695638500 Faqja në Internet: www.upi.al
2. Lloji i procedurës së prokurimit: Tender i hapur	
3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kushtet: "Blerje orendi për ambientet mësimore dhe ndihmese të njësive UPT"	
4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF: 76026-10-19-2020	
5. Fondi limit 41,540,700 (dyzetë e një milion e pesëqind e dyzetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH	
6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 90 ditë pas datës së lidhjes së kontratës.	
7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 19/11/2020 Ora: 10:00 Prokurim elektronik në adresën e APP www.app.gov.al	
8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 19/11/2020 Ora: 10:00 Prokurim elektronik në adresën e APP www.app.gov.al	

Universiteti Politeknik i Tiranës ka realizuar një blerje relativisht të lartë, 49 617 588 Lekësh me TVSH për orendi, për zyrat dhe ambientet mësimore ndaj Erzeni sh.p.k. Por, universiteti ka refuzuar të bëjë publik listën e specifikimeve të mallrave të blerë, pa të cilën pamundësohet informacioni mbi sasinë, çmimin dhe cilësinë e mallrave.

Nr. 878 / Prot. / 10 Tiranë, me 08 / 10 / 2020

KONTRATË

E lidhur sot me datë 08 / 10 / 2020, në Tiranë, midis palëve:

Universiteti Politeknik i Tiranës, me adresë: Sheshi "Nene Tereza", Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Besmir ALI, që tani e tutje do të quhet "Autoriteti Kontraktor", dhe:
Shoqërisë BO "A&T sh.a & OLSI" sh.p.k me NPT L32320008H dhe NPT J634234631, përfaqësuar nga "A&T" sh.a me adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Kati i 7, apartamenti nr 3 Tiranë, përfaqësuar nga Administratori, Z.Fabian Gogji, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

BAZA LIGJORE E KONTRATËS

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Neni 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është Blerje karburanti për nevojat e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Kontraktuesi, duhet të furnizojë UPT-në me karburant, vetëm sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit dhe në ofertën e Kontraktuesit, që janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Nr.	Emërtimi i artikullit	Sasia në litra	Marrëzhi i fitimit i shprehur në përqindje	Afati i realizimit
1	Gazoli D1		18,694 (tetëmbëdhjetë presje gjashtë)	Nga momenti i lidhjes së kontratës deri më 31.12.2020

Vlera e kontratës sipas llogaritjes së çmimit të botuar në buletin nr. 82 datë 05.10.2020 dhe marrëzhi i fitimit të ofertes fituese 6,104,317 (gjashtë milion e njëqind e katër mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë (me TVSH).

c. Kategoria “Blerje mallrash”


Pavarësisht protestës së studentëve në Dhjetor 2018, universitetet kanë vazhduar të shpenzojnë për karburant për makinat e drejtuesve të tyre. 4 nga 6 universitetet e monitoruara kanë shpenzuar karburant për makinat, konkretisht Universiteti i Elbasanit, i Korçës, dhe ai i Durrësit me shpenzimin 5 984 773 Lekë dhe UPT 6 104 317 Lekë.

Qëndresa Qytetare ka siguruar kontratën e lidhur me Univesitetit Politeknik të Tiranës dhe subjektit BO “S&T” sh.a & “OLSI” sh.p.k në 6 Tetor me vlerën **6 104 317 Lekë** me objekt blerjen e karburantit për universitetin. Në brendësi të kontratës

theksohet se furnizimi me karburant mund të bëhet me tallona në pikat e shitjes së subjektit dhe duhet të jetë shpenzuar deri në dt 31 Dhjetor 2020. Pra këto para UPT duhet ti harxhonte si karburant transporti për gati 3 muaj.

Në një kohë kur stafi pedagogjik ka punuar nga shtëpia dhe konferencat apo udhëtimet kanë qënë të kufizuara dhe online, lindi dyshime për sasinë dhe kohën e shpenzimit të kësaj shume për karburant transporti.

Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
IV Blerje mallrash	9,481,542	55,339,972	31,070,503	20,282,678	75,190,026	108,728,921
4.1 Energji elektrike	5,555,047	2,180,990	6,338,090	4,597,103	13,650,904	20,181,461
4.2 Karburant dhe vaj	0	0	2,093,051	507,897	5,984,773	6,104,317
4.3 Ujë	1,346,414	233,981	5,390,879	638,753	3,188,428	3,056,582
4.4 Ngrohje + Pastrim	1,423,632	5,013,085	590,160	4,501,981	2,500,000	21,380,089
4.5 Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0	8,965,113	5,327,880	2,907,487	4,859,688	12,631,740
4.6 Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	487,117	6,121,840	2,159,256	84,480	2,047,999	662,040
4.7 Libra dhe publikime profesionale	93,332	3,899,041	1,821,384	3,487,036	24,700	1,808,979
4.8 Materiale dhe shërbime operative	576,000	347,892	203,700	122,040	3,018,134	3,886,418
4.9 Pajisje Informatike	0	28,578,030	7,146,103	3,435,901	39,567,600	38,753,415
4.1 Materiale të tjera	0	0	0	0	347,800	263,880
0						



Një fakt interesant vihet re tek shpenzimet për ngrohje dhe pastrim, pasi në një kohë ku universitetet kanë qënë pa studentë dhe pedagogë për shkak të mësimi në distancë brenda për një vit akademik, janë blerë lëndë djegëse në shifra të larta nga ana e tyre.

Universiteti i Shkodrës, pavarësisht se nuk e ka kaluar në zërin e duhur në transaksionet e thesarit ka shpenzuar 6 250 000 Lekë për të blerë gazoil për ngrohje për kaldajat, sipas kontratës së nënshkruar më 13/04/2021.

Universitet Politeknik i Tiranës ka shpenzuar shifrën e konsiderueshme prej 21,380,089 Lekësh për zërin "Ngrohje dhe Pastrim" në një kohë kur godinat nuk kanë pasur nevojë për pastrim dhe ngrohje.

Gjithashtu UAMD, UPT dhe UT kanë bërë shpenzime të konsiderueshme për blerje pajisjesh informatike, përkatësisht UAMD në vlerën 39,567,600 Lekë, UPT në vlerën 38,753,415 Lekë dhe UT në vlerën prej 28,578,030 Lekë.

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka blerë në 30 Mars të këtij viti nga kompania "Atom Computer" 135

kompjutera desktop, 20 video – projektorë dhe pajisje të tjera elektronike të cilat e kanë çuar vlerën e kontratës në masën 17 616 000 Lekë. Qëndresa Qytetare nuk zotëron një inventar të këtij universiteti për të identifikuar nevojat e mundshme por duke pasur parasysh numrin e sallave, laboratorëve dhe zyrave që disponon ky universitet duket një sasi e lartë dhe ka nevojë për një verifikim nga organet kompetente si KLSH dhe Drejtoria e Auditit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Krahasuar me vitet e mëparshme bie në sy një element i përmirësuar në rrafshin e shpenzimeve, ku të gjashta universitetet kanë shpenzuar para për të blerë libra, megjithëse në vlera minimale në raport me buxhetin dhe mundësitë e tyre.

Neni 13: Çmimi i Kontratës

13.1 Çmimi i kontratës bazuar në procedurën e prokurimit të zhvilluar elektronikisht në faqen zyrtare www.app.gov.al më datë 30.03.2021, ora 11:00, është 14,680,000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe 17,616,000 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë me TVSH.

13.2 Çmimi i kësaj kontrate për të gjitha zërat e përcaktuara në preventivin e mëposhtëm do të jetë i pandryshuar deri në përbushjen e plotë të detyrimeve që Kontraktuesi ka marrë përsipër nëpërmjet kësaj kontrate.

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi	Vlera	Afati
1	Kompjuter Desktop 1	135	84,000	11,340,000	15 dite
2	Projektor Tip 1	20	63,000	1,260,000	15 dite
3	UPS 600VA	135	6,500	877,500	15 dite
4	Router Wifi Profesional	4	125,700	502,800	15 dite
5	License per firewall	1	699,700	699,700	15 dite
Çmimi Neto				14,680,000	
TVSH %				2,936,000	
Çmimi Total				17,616,000	

UNIVERSITETI I TIRANËS

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:
Emri UNIVERSITETI I TIRANËS
Adresa Blv. "Dëshmorët e kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kishilli i Ministrave Tel.: 355 4 22 77 510 <http://www.app.gov.al> 251/356

Buletini Nr. 34 datë 8 Mars 2021

Agjencia e Prokurimit Publik

Tel/Fax Tel. +35542258446
E-mail s_dafa@unitir.edu.al
Faqja në Internet www.unitir.edu.al

- Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur.
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Loti 1 - Blerje letër A4, materiale kancelarie për UT.
- Numri i referencës së procedurës/lotit: Loti 1 - REF-80439-11-27-2020.
- Fondi limit: Loti 1 - 8,549,410 (tetëmilion pesëqind e dyzet e nëntë mijë katërqind e dhjetë) lekë pa TVSH.
- Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opcionet dhe nënkontraktimin):
Loti 1 - 8,553,113.05 (tetëmilion tetëqind e pesëdhjetë e tremijë njëqind e trembëdhjetë pikë zero pesë) lekë me TVSH.
- Data e lidhjes së kontratës: Për Lotin 1 – 26.02.2021.
- Emri dhe adresa e kontraktorit/nënkontraktorit:
Për Lotin 1 - "IT GJERGJIL KOMPIJUTER" ShPK me adresë: Rruga "Dervish Hima" prapa

Qëndresa Qytetare ka hedhur dritë edhe mbi zërat e "Kancelarive" që kanë përdorur universitetet publike. Vetëm Universiteti i Shkodrës nuk ka shpenzuar për këtë zë, ndërsa 5 universitetet e tjera kanë pasur një buxhet relativisht të lartë pavarësisht se jeta akademike ka qënë e paralizuar. Universiteti i Tiranës e ka përdorur pothuajse të gjithë buxhetin e këtij zëri 8 853 113 lekë për të blerë letra A4. Duke marrë në konsideratë faktin që një pako me letra A4 kushton vetëm 500 lek, presupozohet të ketë një nivel të lartë stoku në magazinat e tij. Nëse do të përpjestonim shumën e shpenzuar me çmimin e një pako letrë A4, rezulton të ketë blerë rreth 17 700

pako letër A4. Në mungesë të transparencës së kontratës reale buletini i prokurimeve mbetet dokumenti i vetëm provues për këtë shpenzim.

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka realizuar një shpenzim i cili përshkruhet si vijon "Spango me fije najloni gjatësia 28 metër" dhe është blerë në masën 250 copë për të siguruar një gjatësi 9500 metër.

d. Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Sigurimi i godinave të universiteteve me roje private vijon të zërë peshën kryesore të shpenzimeve të disa prej universiteteve publike. Pavarësisht kritikave që Kryeminsitri Rama u drejtoi Rektorëve për këtë zë dhe protesta studentore e vitit 2018, drejtuesit e universiteteve nuk janë treguar racionalë në këtë drejtim. Gjashtë universitet publike të monitoruara kanë shpenzuar rreth 2.2 milion Euro për sigurinë e godinave të universiteteve, shumë e cila mund të tejkalojë edhe vlerën që kanë pajisjet që ndodhen brenda tyre.

UNIVERSITETI I TIRANËS

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri **UNIVERSITETI I TIRANËS**
Adresa Blv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë
Tel/Fax Tel. +35542258446
E-mail s_dafa@unitir.edu.al
Faqja në Internet www.unitir.edu.al
- Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur.
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **Loti 2 – “F.V. Sistem kamerash”.**
- Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81513-12-09-2020.
- Fondi limit total: 24,166,666 (njëzet e katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh.
- Vlera totale përfundimtare e kontratës: **28,578,030 (njëzet e tetë milion pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë) lekë me TVSh.**
- Data e lidhjes së kontratës: 09.02.2021.
- Emri dhe adresa e kontraktorit/nënkontraktorit:
“PC STORE” shpk, me adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë, NIPT L01606034A.

Universiteti i Tiranës ka shpenzimin më të lartë për këtë zë me 67 185 066 Lekë vetëm për rojet tek dyert e godinave, të cilat gjatë gjithë vitit kanë qenë bosh, pa studentë dhe pedagogë. Por përkujdesja e drejtuesve të universiteteve nuk ka qënë e fokusuar vetëm tek siguria e jashtme por edhe e brendshme. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar për të **instaluar kamera brenda universitetit plot 28 578 030 Lekë.**

UNIVERSITETI POLITEKNIK TIRANË

Për: Shoqërinë “ANSIG” sh.a
Adresa: Rruga “Donika Kastrioti”, Nr.9/1, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Shërbimi i sigurimit të pasurisë së Universitetit Politeknik të Tiranës”.
Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i sigurimit të pasurisë së Universitetit Politeknik të Tiranës”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e lidhjes së kontratës.

REF-71984-09-16-2020

Fondi limit: 2,500,000 (dymilion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i Financimit: nga Buxheti i Shtetit.

Shpenzim +

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë 1 (një) ofertues me vlerën e ofruar si më poshtë:

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 261/453

Ndërkohë Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpenzuar **2 500 000 Lekë për sigurimin e pasurisë së universitetit**, përveç 38 886 745 Lekësh të shpenzuara për ruajtjen fizike të godinës. Ndërsa Universiteti i Elbasanit, i cili administron një numër më të ulët godinash ka shpenzuar gati dyfish më shumë se universitetet e tjera të rretheve. Për sa i përket shpenzimeve për Telefon

dhe Internet, gjashtë universitetet e kanë përdorur zërin por UPT ka shpenzimet më të larta me vlerë rreth 3.4 milionë Lekë të reja.

Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
V Sigurimi i shërbimeve	32,370,924	163,876,151	93,734,199	24,777,896	36,628,423	59,308,535
5.1 Posta dhe shërbimi korrier	58,000	152,734	50,340	35,030	45,930	136,414
5.2 Telefon dhe internet	279,451	938,440	716,610	175,701	195,137	3,378,420
5.3 Pastrim dhe gjelbërim	0	12,379,026	2,769,122	825,000	654,659	1,905,131
5.4 Shërbime të tjera transporti	451,704	566,521	601,854	547,739	722,687	1,134,127
5.5 Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	27,810,556	67,185,066	50,640,664	20,803,237	23,170,929	38,886,745
5.6 Shërbime të tjera	3,716,400	3,546,776	14,798,900	0	165,122	7,368,906
5.7 Aktivitete sociale për personelin (dhe pjesëmarrje në evente e konferenca)	0	237,954	0	88,309	391,075	776,043
5.8 Mirëmbajtje ndërtesash	54,813	45,406,298	9,407,292	1,597,800	6,482,574	1,742,520
5.9 Instalim dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike	0	31,149,480	11,674,165	705,080	238,000	3,223,497
5.10 Mirëmbajtje të tjera	0	2,313,856	3,075,252	0	4,562,310	756,732

e. Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”

Kategoria **Transferta dhe Subvencione** tregon edhe njëherë mungesën e projekteve ku janë të përfshira universitetet e monitoruara, ku përvec Universitetit të Elbasanit që ka realizuar një pagesë për zërin e “Projekteve” në masën 4 017 015 Lekë, universitetet e tjera kanë shpenzuar 0 Lekë për projekte, të cilat kryesisht janë shkencore dhe përfshijnë stafin akademik dhe studentët. Universiteti i Tiranës dhe ai i Elbasanit kanë paguar gjatë këtij viti shuma të mëdha për vendimet gjyqësore për shkak të heqjes pa të drejtë nga puna të punjonjësve të tyre, ndërsa vetëm Universiteti i Shkodrës nuk ka shpenzuar për këtë zë.

Përsa i përket mbështetjes financiare me bursa studimi dhe mbështetje të nxënësve të dalluar Universiteti i Elbasanit vazhdon të jetë universiteti me vlerën më të lartë të transaksioneve të kryera, me një total prej 123,205,484 Lekësh pasuar nga UPT me totalin prej 109,359,206 Lekë.

	Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
VI	Transferta dhe Subvencione	1,494,816	14,758,441	5,616,903	3,276,938	8,058,816	46,718,597
6.1	Transferta për projekte	0	0	4,017,015	0	0	0
6.2	Kuota Anëtarësimi	100,000	789,396	454,913	245,600	960,464	1,195,072
6.3	Komisione Bankare	1,394,816	13,969,045	1,144,975	3,031,338	7,098,352	45,523,525
VII	Të tjera	54,980,000	2,562,105	124,974,314	45,290,388	75,942,388	109,930,140
7.1	Mbështetje e studentëve dhe bursa studimi	54,980,000	0	123,205,484	45,270,000	75,265,943	109,359,206
7.2	Shpenzime gjyqësore	0	2,562,105	1,768,830	20,388	676,445	570,934

f. Kush janë kontraktorët preferencialë të universiteteve publike?


Gjatë punës monitoruese u evidentua se universitetet publike pavarësisht se operojnë në qytete të ndryshme dhe drejtohen nga autoritete të ndryshme, përbashkohen tek disa kontraktorë të njëjtë ndaj të cilëve blejnë mallra dhe shërbime. Kompania që ka marrë fonde nga gjashtë universitetet e monitoruara është Ulza Ndërtim, me një vlerë totale transaksionesh prej 1.3 milion Euro. Kompania që renditet e dyta për nga vlera e parave të akorduara nga këto universitete është "UDHA" me një total rreth 850 000 Euro. Kompania e tretë është "Ilyrian Guard" me një total transaksionesh prej 800 000 Euro, fonde të cilat i ka marrë nga 3 universitete, përkatësisht Universiteti i Shkodrës, Tiranës dhe ai Politeknik. Erzeni sh.p.k. gjithashtu ka marrë prej Universitetit të Tiranës dhe UPT. Po kështu edhe "PC Store" dhe "Atom" kompjuter, kompani të njohura në fushën e teknologjisë kanë marrë fonde nga disa universitete njëherazi.

Nisur nga fakti se Bordet e Administrimit, të cilat janë edhe organet që vendosin për kontratat dhe shpenzimet janë të emëruara nga Ministria e Arsimit, mund të hidhet hije dyshimi që edhe orientimi drejt kompanive kontraktore mund të ketë një tendencë të centralizuar nga titullarët e kësaj minsitrie.

g. Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike për vitin akademik 2020-2021

	Kategori/Nënkategori	U. Shkodrës	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçës	U. Durrës	U.P.T
II	Shpenzime personeli	311,446,500	74,864,303	367,456,470	263,947,957	486,192,147	666,940,710
2.1	Paga	291,755,792	50,113,708	263,042,037	241,402,391	218,492,633	532,361,054
2.2	Honorare + Të tjera shperblime për personelin	5,158,097	23,319,021	100,136,899	7,775,505	211,480,865	43,288,269
2.3	Paga me kontratë për kohë të kufizuar	13,474,088	1,028,000	0	10,164,749	45,521,418	43,875,787
2.4	Dieta Udhetime	804,370	403,574	575,733	2,499,362	1,181,161	12,340,042
2.5	Pagesa anëtarët e bordit administrativ (+ Senati)	254,153	0	3,701,801	2,105,950	9,516,070	35,075,558
III	Investime	12,408,582	189,801,466	31,011,162	18,034,490	125,303,500	178,815,832
3.1	Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	11,706,582	160,248,261	0	15,230,610	93,350,585	104,673,929
3.2	Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0
3.3	Mjete transporti	0	0	0	0	0	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	702,000	0	15,399,120	1,941,680	9,330,035	22,470,066
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	0	29,553,205	15,525,942	862,200	22,622,880	49,617,588
3.6	Studime dhe kërkime	0	0	86,100	0	0	2,054,249
IV	Blerje mallrash	9,481,542	55,339,972	31,070,503	20,282,678	75,190,026	108,728,921
4.1	Energji elektrike	5,555,047	2,180,990	6,338,090	4,597,103	13,650,904	20,181,461
4.2	Karburant dhe vaj	0	0	2,093,051	507,897	5,984,773	6,104,317
4.3	Ujë	1,346,414	233,981	5,390,879	638,753	3,188,428	3,056,582
4.4	Ngrohje + Pastrim	1,423,632	5,013,085	590,160	4,501,981	2,500,000	21,380,089
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0	8,965,113	5,327,880	2,907,487	4,859,688	12,631,740
4.6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	487,117	6,121,840	2,159,256	84,480	2,047,999	662,040
4.7	Libra dhe publikime profesionale	93,332	3,899,041	1,821,384	3,487,036	24,700	1,808,979
4.8	Materiale dhe shërbime operative	576,000	347,892	203,700	122,040	3,018,134	3,886,418
4.9	Pajisje Informatike	0	28,578,030	7,146,103	3,435,901	39,567,600	38,753,415
4.10	Materiale të tjera	0	0	0	0	347,800	263,880
V	Sigurimi i shërbimeve	32,370,924	163,876,151	93,734,199	24,777,896	36,628,423	59,308,535
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	58,000	152,734	50,340	35,030	45,930	136,414
5.2	Telefon dhe internet	279,451	938,440	716,610	175,701	195,137	3,378,420
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	0	12,379,026	2,769,122	825,000	654,659	1,905,131
5.4	Shërbime të tjera transporti	451,704	566,521	601,854	547,739	722,687	1,134,127
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	27,810,556	67,185,066	50,640,664	20,803,237	23,170,929	38,886,745
5.6	Shërbime të tjera	3,716,400	3,546,776	14,798,900	0	165,122	7,368,906
5.7	Aktivitete sociale per personelin	0	237,954	0	88,309	391,075	776,043
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	54,813	45,406,298	9,407,292	1,597,800	6,482,574	1,742,520
5.9	Instalim dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike	0	31,149,480	11,674,165	705,080	238,000	3,223,497
5.10	Mirëmbajtje të tjera	0	2,313,856	3,075,252	0	4,562,310	756,732
VI	Transfera dhe Subvencione	1,494,816	14,758,441	5,616,903	3,276,938	8,058,816	46,718,597
6.1	Transfera për projekte	0	0	4,017,015	0	0	0
6.2	Kuota Anëtarësimi	100,000	789,396	454,913	245,600	960,464	1,195,072
6.3	Komisione Bankare	1,394,816	13,969,045	1,144,975	3,031,338	7,098,352	45,523,525
VII	Të tjera	54,980,000	2,562,105	124,974,314	45,290,388	75,942,388	109,930,140
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	54,980,000	0	123,205,484	45,270,000	75,265,943	109,359,206
7.2	Shpenzime gjygesore	0	2,562,105	1,768,830	20,388	676,445	570,934
	Totali	422,182,364	501,202,438	653,863,551	375,610,347	807,315,300	1,170,442,735

6. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL



Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxori VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.

Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ky portal nuk përmban të

dhëna mbi shpenzimet në nivel universiteti apo rektorati por vetëm të dhëna në nivel fakulteti, gjë që u vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të universitetit dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

Një tjetër mangësi e këtij portali janë prokurimet publike, ku për vitin 2020 - 2021 nuk kemi të publikuar asnjë kontratë të lidhur nga asnjë universitet, ndërkohë që nga monitorimi ynë rezultojnë dhjetëra kontrata të lidhura nga universitetet me operatorë privatë të tretë nëpërmjet procedurave të tenderimit.

Ndërsa sa i përket vendimeve të organeve administrative dhe akademike, janë publikuar vetëm ato vendime që kanë lidhje me bursat dhe tarifat, por jo vendime me efekt financiar dhe legjislativ brenda universitetit.

Njëkohësisht ky portal duhet të përmbante të gjitha CV-të e pedagogëve të universiteteve sipas VKM, brenda muajit Shkurt, por ende shohim që ka shumë mangësi në këtë drejtim dhe pothuajse i gjithë materiali ka mangësi informacioni.

Në pikën "gj" të këtij vendimi parashikohet se brenda portalit u-transparenca.al do të gjenden edhe rezultatet e verifikimit të titujve akademikë, por kjo kategori nuk është parashikuar dhe nuk ekziston në portal. Gjithashtu procesi nuk është më në duart e Minsitrisë dhe ju ka kaluar vetë universiteteve të cilat e kanë kthyer verifikimin në vetëdeklarim.

8. REKOMANDIME

- Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të nisë menjëherë auditim për rregullshmërinë financiare të universiteteve publike në vend duke marrë në shqyrtim buxhetet, bilancet, kontratat dhe gjendjen e magazinuar të mallrave të blera nga paratë e tarifave të studentëve.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të zbatojë plotësisht VKM 781, dt. 26.12.2018 duke përditësuar dhe plotësuar me kategoritë që mungojnë portalin u-transparenca.al përfshi këtu, vendimet e zbardhura të Bordeve të Administrimit, kontratat me të tretët dhe prokurimet për vitin 2020 - 2021.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të inspektojë buxhetet, transaksionet dhe ofrimin e shërbimeve të universiteteve publike sipas parashikimeve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore në raste shkeljesh.
- Universitetet publike duhet të përditësojnë dhe personalizojnë programet e transparencës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe të aplikojnë vendimmarrje financiare të hapur, me përfshirjen e studentëve e në konsultim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale.
- Universitetet publike duhet të alokojnë më shumë para për zërat e "Kërkimit shkencor" dhe "Pasurimit të bibliotekave" të tyre me librat që përmban kurikula mësimore dhe më pak para për "Siguri, kamera dhe siguracione godinash".
- Këshillat Studentore dhe përfaqësuesit e studentëve në Bordet e Administrimit duhet të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke verifikuar çdo blerje, çdo kontratë lidhur me të tretët dhe çdo shërbim të ofruar nga universiteti ku studiojnë dhe të informojnë studentët mbi këto fakte.
- Këshillat Studentore dhe studentët të kërkojnë nga anëtarët e Bordit të Administrimit të propozuar prej tyre llogari periodike për çdo veprim financiar që ka ndërmarrë universiteti.

**Universiteti i Tiranës**

Skeda e Transparencës

VITI AKADEMIK 2020- 2021 | PLOTË ONLINE

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

	2020-21	19-20	18-19
